Nr 6 prot
dt 20.01.2012

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse
Drejtoria e Shërbimeve Juridike

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", 1001 Faqja ëeb: http:/ëëë.mete.gov.al

6930/1

21.01.2012

U R D H Ë R

Nr. 21 **, dt.** 20/01/2012 **2011**

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES

PER

ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PER NDJEKJEN E PROÇEDURAVE TË ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË NE NISMËN PER TRANSPARENCE NE INDUSTRINË NXJERRËSE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të Urdhërit të Kryeministrit nr. 71, datë 21.7.2011 "Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Ndjekjen e Procedurave te Anëtarësimit të Shqipërise në Nismën për Transparence në Industrinë Nxjerrëse" , me propozim të Drejtuesit të Sekretariatit,

U R D H Ë R O J:

1. Miratimin e Rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Ndjekjen e Procedurave te Anëtarësimit të Shqipërise në Nismën për Transparence në Industrinë Nxjerrëse".

2. Ngarkohet Kryetari i Grupit të Punës me marrjen e masave për sigurimin e zbatimit të Rregullores nga anëtarët e grupit..

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

NASIP NAÇO

RREGULLORE
PER
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PER NDJEKJEN E PROÇEDURAVE TË ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË NE NISMËN PER TRANSPARENCE NE INDUSTRINË NXJERRËSE

-Miratuar me Urdhrin nr. 20, datë 20 / 01 /~~2011~~ 2012 te Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes, Z. Nasip Naço.

Kjo rregullore hartohet ne baze te pikes 5 te Urdherit te Kryeministrit nr. 71 date 21.07.2011 "Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit Ndërinstitucional te Punës per Ndjekjen e Procedurave te Anetaresimit te Shqiperise ne Nismen per Transparence ne Industrine Nxjerrese (EITI)"

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat lidhur me:

a) Organizimin dhe funksionimin e mbledhjeve te Grupit Ndërinstitucional te Punës ose Multi Stakeholder Group (MSG) për ndjekjen e procedurave te anëtarësimit te Shqipërisë ne *"Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)*, "*më poshtë MSG*".

b) Pergatitjen, paraqitjen, shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve nga MSG.

Neni 2

Baza Ligjore

Grupi Ndërinstitucional i Punës për ndjekjen e procedurave te anëtarësimit te Shqipërisë ne ***"Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI)*** funksionon duke u bazuar ne legjislacionin e meposhtem:

1. Ligji nr. 8485, date 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative".

2. Ligji nr. 8480, date 27.5.1999 "Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shteterore dhe enteve publike", "me poshte referohet ***ligji nr. 8480***".

3. VKM Nr.540, datë 07.07.2010 "Për ngritjen dhe funksionimin e Sekretariatit për ndjekjen e procedurave te anëtarësimit te Shqipërisë si vend zbatues ne Nismën për Transparence ne Industrinë Nxjerrëse", i ndryshuar.

4. Urdheri i Kryeministrit nr. 71 date 21.07.2011 "Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit Ndërinstitucional te Punës per Ndjekjen e Procedurave te Anetaresimit te Shqiperise ne Nismen per Transparence ne Industrine Nxjerrese (EITI)" (me poshte Urdheri nr. 71).

Neni 3

Perkufizime

Per qellime te kesaj rregullorej termat e meposhtem kane kete kuptim:

1. "MSG" eshte grup nderinstitucional pune (vendimmarres) per ndjekjen e procedurave te anetaresimit te Shqiperise ne Nismen per Transparence ne Industrine Nxjerrese (EITI). Misioni dhe perberja e MSG percaktohen ne Urdherin nr. 71 te Kryeministrit.

2. "ALBEITI" eshte Sekretariati Nisma Për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse, "*me poshte referohet Sekretariati*".

3. "Projekt" jane projekt-vendimet, projekt-urdhera, projekt-udhezime qe dergohen prane MSG per shqyrtim.

Neni 4

Misioni i MSG

MSG ndjek procedurat e anëtarësimit te Shqipërisë si vend zbatues i Nismës për Transparence ne Industrinë Nxjerrëse, për plotësimin dhe zbatimin ne vazhdimësi te procedurave te EITI .

Neni 5

Detyrat e MSG

5.1 Aprovon plane afatshkurtra dhe afatgjata te veprimtarisë për anëtarësimin në EITI dhe analizon periodikisht zbatimin e programeve.

5.2 Mbikëqyr dhe vlerëson te gjithë punën e Sekretariatit te ALBEITI, ne mënyrë periodike dhe informon Kryeministrin dhe Ministrin përkatës.

5.3 Informohet për veprimtarinë e Sekretariatit te ALBEITI në periudhën ndërmjet 2 mbledhjeve.

5.4 Miraton te gjitha aktet e nevojshme për veprimtarinë e Sekretariatit ALBEITI **sipas procedurave te sekretariatit ndërkombëtar te EITI.**

5.5 Miraton termat e tenderit për përzgjedhjen e audituesit (rekoncilieri dhe validatori) për zbatimin e EITI ne Shqipëri.

5.6 Mbikëqyr aktivitete te tjera te nevojshme për anëtarësim ne EITI dhe ne vazhdim.

Neni 6

Perberja e MSG

6.1 MSG ka ne përbërje këta anëtare :

a) Një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes.
b) Një përfaqësues nga ministria e Financave.
c) Një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.
d) Një përfaqësues nga Drejtoria e përgjithshme e Tatimeve.
e) Një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.
f) Një përfaqësues nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.
g) Pesë përfaqësues nga biznesi, te përzgjedhur nga rrjeti Kombëtar i Industrisë Nxjerrëse
h) Pesë përfaqësues nga shoqëria civile, te përzgjedhur nga Rrjeti Kombëtar për Shoqërinë Civile për EITI-ne

6.2 Niveli i përfaqësimit ne MSG për Institucionet shtetërore do te jete jo me i ulet se drejtor drejtorie.

6.3 Kryetari i MSG është një prej Zv/ministrave te Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes (METE).

6.4 Anëtaret e MSG qe perfaqesojne Qeverinë, emërohen dhe lirohen nga detyra , nga titullari i institucionit përkatës.

6.5 Me ftesë të kryetarit te MSG, ne mbledhjet e këtij grupi mund të marrin pjesë përfaqësues nga institucione te tjera, rrjeti Kombëtar i Industrisë Nxjerrëse dhe Shoqërisë Civile për EITI-ne.

Neni 7

Mbledhjet e MSG

7.1 MSG zhvillon veprimtarinë nëpërmjet mbledhjeve te anëtareve te tij dhe marrjes se vendimeve.

7.2 MSG i zhvillon mbledhjet , si rregull, ne selinë e METE-s ose ne një vend te përcaktuar prej tij.

7.3 Mbledhjet e MSG zhvillohen jo me pak se një here ne 2 muaj

7.4 Mbledhjet e MSG thirren me nismen e Kryetarit te MSG ose me kerkesen e 1/3 se anëtareve te tij. Ministri ka te drejte te thërrasë mbledhjen e MSG , kurdoherë qe e vlerëson të nevojshme. **Kerkesa duhet te permbaje qellimin, rendin e dites dhe arsyen per thirrjen e mbledhjes.**

7.5 Ne mbledhjet e MSG mund te thirren për te marre pjese me ftese te Kryetarit dhe përfaqësues te tjerë te Qeverise, Shoqërisë Civile dhe kompanive ne industrinë Nxjerrëse.

7.6 Mbledhjet e MSG thirren duke komunikuar kohen, vendin dhe rendin e dites se mbledhjes se bashku me materialet per shqyrtim per gjithe anetaret e MSG, te pakten 5 (pese) dite kalendarike, perpara dates se caktuar per mbledhje. Materialet per shqyrtim u vihen ne dipsozicion anetareve te MSG me rruge elekronike.

7.7 Mbledhjet e MSG jane te vlefshme nese marrin pjese më shumë se gjysma e anëtareve te MSG. Ne rastet kur nuk

plotesohet ky numer, Kryetari vendos thirrjen e mbledhjes ne një dite tjetër, te paktën 24 ore pas se pares.

7.8 Mbledhjet e MSG drejtohen nga Kryetari dhe ne mungese te tij nga një anëtar i autorizuar prej tij.

7.9 Ne fund te mbledhjes, Kryetari deklaron mbylljen e saj. Nese ceshtjet e rendit te dites nuk arrijne te shqyrtohen brenda dites se mbledhjes, ai vendos vazhdimin e mbledhjes ne nje dite tjeter ose perfshirjen e tyre ne rendin e dites se mbledhjes se ardhshme te MSG.

7.10 Çdo anetar i MSG nuk merr pjese ne procedurat e diskutimit, votimit dhe vendimmarrjes, nese kane interes te drejtperdrejte apo te terthorte per ceshtjen, interes i cili cenon paanesine e tyre ne vendimet qe do te merren.

Neni 8

Menyra e paraqitjes se materialeve ne mbledhjen e MSG

8.1 Drejtuesi i Sekretariatit paraqet sa here qe i kerkohet nga MSG raporte dhe informacione mbi veprimtarine e Sekretariatit, zbatimin e vendimeve te MSG dhe çeshtje te tjera.

8.2 Kane te drejte te paraqesin materiale per shqyrtim ne mbledhjet e MSG, Drejtuesi i Sekretariatit , anetaret e MSG **(dhe nese ka te tjere, plotesoje vete).**

8.3 Materialet qe paraqiten per shqyrtim ne mbledhjen e MSG depozitohen prane sekretarit te MSG, i cili ia paraqet Kryetarit te MSG.

8.4 Materialet qe paraqiten per shqyrtim ne mbledhjen e MSG ndahen ne dy grupe si me poshte:

i. materiale me karakter te pergjithshem dhe informativ te cilat per efekt te kesaj rregullorej do te quhen **"informacione".**

ii. materiale me propozime konkrete qe jane te detyrueshme te shqyrtohen ne mbledhjet e MSG, te cilat mund te miratohen pa ndryshime, me ndryshime ose mund te mos miratohen. Materialet e kesaj natyre per efekt te kesaj rregulloreje do te quhen **"projekte".**

8.5 Çdo projekt-vendim qe i paraqitet MSG per miratim duhet te jete i shoqeruar me relacionin perkates, sipas struktures se meposhteme:

- qellimin, rendesine, aktet ligjore dhe nenligjore ne te cilin bazohet projekti i paraqitur, sqarime per ndryshimet ne rastet qe ndryshohet akti ekzistues dhe efektet ekonomike nese ka te tilla;

- strukturen propozuese, objektin, problemet perkatese te cilat i paraqiten MSG per miratim;

- perfshirjen e mendimit te strukturave te tjera te interesuara per problemin qe shqyrtohet;

Neni 9

Procedura e marrjes se vendimeve dhe e votimit ne mbledhjet e MSG

9.1 Vendimi eshte i vlefshem kur votojne më shumë se gjysma e anëtareve me te drejte vote, te pranishem ne mbledhje. Votimi eshte i hapur. Çdo anetar ka te drejten e nje vote. Kryetari i MSG voton i fundit. Ne rastet kur rezultati i votimit eshte i barabarte, vota e kryetarit eshte vendimtare. Ne votim nuk lejohet abstenimi. Anetaret qe jane te pranishem dhe qe nuk kane asnje pengese ligjore per te votuar, votojne pro ose kunder. Vota kunder argumentohet.

9.2 MSG, si rregull miraton vendime mbi bazen e "" **projektit**" te paraqitur, por ne raste te vecanta MSG mund te marre vendime edhe mbi bazen e informacioneve te paraqituara per shqyrtim apo propozimeve te bera gjate diskutimit.

9.3 Per çdo " **projekt**" te paraqitur, MSG merr vendim me vete. Ne rastet kur ne mbledhjen e MSG nuk ka verejtje dhe nuk behen propozime per ndryshime, "**projekti**" votohet dhe miratohet ne formen e paraqitur.

9.4 Ne rastet kur ne projektin e paraqitur ne mbledhje behen verejtje, "**projekti**" votohet ne parim dhe nese votohet pro miratimit te tij, atehere kalohet ne votimin e çdo propozimi te bere nga secili anetar dhe ne fund vendoset per "projektin" me ndryshimet e bera ne mbledhje. Ne te kunderten "**projekti**" nuk miratohet.

Neni 10

Zbardhja dhe marrja fuqi e vendimeve te MSG

10.1 Zbardhja e vendimeve te MSG behet nga sekretari i MSG, brenda 5 (pese) diteve pune pas dites se perfundimit te mbledhjes.

10.2 Ne rastet kur "**projekti**" nuk miratohet, MSG nuk merr vendim. Strukurat propozuese te "**projektit**" informohen me shkrim per arsyet e mosmiratimit.

10.3 Vendimet e MSG zbardhen ne dy kopje, njera prej te cilave nenshkruhet nga Kryetari. Kopja tjeter nenshkruhet nga te gjithe anetaret pjesemarres ne mbledhje.

10.4 Vendimet e nenshkruara nga Kryetari i MSG depozitohen dhe regjistrohen ne nje liber te vecante ne zyren e protokoll-arkivit te METE-s.

10.5 Vendimet e nenshkruara nga te gjithe anetaret depozitohen te sekretari i MSG.

10.6 Vendimet e miratuara do te nxirren nga zyra e protokoll-arkives dhe do te qarkullojne vetem me nenshkrimin e Kryetarit te MSG.

10.7 Kryetari i MSG nepermjet sekretarit i dergon vendimet e miratuara nga MSG, strukturave perkatese te cilat ngarkohen me ndjekjen dhe zbatimin e tyre.

Neni 11

Dispozita te fundit

11.1 Protokolli i mbledhjeve te MSG perfaqeson bllokun e procesverbaleve te mbajtjes se mbledhjeve te MSG. Protokolli mbahet nga sekretari i MSG.

11.2 Procesverbali i mbledhjeve mbahet sipas ***ligjit nr. 8480***, neni 16.

11.3 Kjo rregullore merr fuqi dhe behet e detyrueshme për zbatim, menjëherë me miratimin e saj nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes.